



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

**VENDIM
Nr. 709, datë 03.12.2024
PËR**

**PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E
APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DHE GJYKATËN E LARTË
PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS PENALE, TË
SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 502 DHE NR. 503 DATË 21.11.2022 DHE NR.178,
DATË 11.05.2022, PËR KANDIDATEN ZNJ. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 2, të nenit 64, të Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, i ndryshuar, si dhe në pikën 36, Seksioni B, Kreu V, të Vendimit të tij nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, pasi shqyrtoi kërkesën e kandidatit për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 502 dhe nr. 503 datë 21.11.2022 dhe procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 178 datë 11.05.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbi propozimin e relatorit të çështjes,

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën e Lartë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 502 dhe nr. 503 datë 21.11.2022 dhe Vendimin nr. 178 datë 11.05.2022, për kandidaten znj. {...} për shkak të tërheqjes nga kandidimi për këtë pozicion.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...} , sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR